

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"AUTOMODIF GROUP ALBANIA" SH.P.K.

KREU I
Ortakët dhe Baza ligjore

Sot, në datën 15/12/2023 (dy mijë e njetzet e tre) ne, personat e mëposhtem:

- 1- **Z., Orhan Yalçın i biri i Mehmet, lindur më 20.09.1978 në Turkeli, Turqi dhe banues në, Rr Bakalli, banesa 18, Yzberisht, njesia 14, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. U25904805 dhe**
- 2- **Z., Erdi Yuksel I biri i Seref, lindur më 18.06.1999 në Ayancik, Turqi dhe banuese në, Rr Bakalli, banesa 18, Yzberisht, njesia 14, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. U15542364**

në cilësinë e "Ortakut Themelues", me vullnet të lire të plotë e në bazë të nismës së lirë pivate, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil në fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit", vendosi të themelojë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin "AUTOMODIF GROUP ALBANIA" SH.P.K

KREU II
Kuotat, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore
Neni 1
Emri dhe Ortakët

- 1.1 Shoqëria është e organizuar dhe funksionon sipas formës "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" dhe mban emrin "AUTOMODIF GROUP ALBANIA" SH.P.K.
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

Neni 2
Objekti

Shoqëria "AUTOMODIF GROUP ALBANIA" SH.P.K do të ketë objekt veprimtarie:



1. Tregëtia e pjeseve të kembimi të automjeteve.

Shoqëria, në mënyrë dytesore dhe jo në mënyrë të drejtperdrejte, dhe sidoqofte vetëm për të përmbushur objektin e saj tregtar, mund të kryejë çdo veprimtari tregtare e cila do të konsiderohet si e nevojshme dhe e domosdoshme duke përfshirë edhe zoterimin e kuotave ose pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera tregtare që ushtrojnë aktivitete të ngjashme me aktivitetin e ushtruar nga vete Shoqëria si dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave që lidhen me zoterimin e këtyre kuotave/pjesëmarrjeve.

Neni 3 Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Ortakëve, sipas kuorumit përkatës vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqëria "AUTOMODIF GROUP ALBANIA" SH.P.K gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar të QKB-së.

Neni 4 Zyra Qendrore

- 4.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rr Bakalli, banesa 18, Yzberisht, njesia 14, Tiranë.**
- 4.2 Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqesimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e kërkuar në fuqi sipas juridiksionit të vendit përkatës.

KREU III

Neni 5 Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 lekë** (njëqind mijë) i formuar në masë të plotë nga kontributet e ortakëve. Çdo kuotë njësie ka të drejtën e (1) një vote. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij si më poshtë:
 - Ortaku themelues **Z. Orhan Yalçin**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **50.000 lekë** (pesedhjetë mijë) që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - Ortaku themelues **Z. Erdi Yuksel**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **50.000 lekë** (Pesedhjetë mijë) që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- 5.2 Kontributet sa më sipër janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ana e ortakut të shoqërisë.



Neni 6
Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të cilësuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e cilësuar (tre të katërtat) e votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e cilësuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që të respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqërite Tregtare.

KREU IV
Neni 7
Kuotat dhe Kalimi i Kuotave

- 7.1** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndërmjet paleve.
- 7.2** Transferimi i kuotave të ortakëve të shoqërisë brenda ortakërisë apo në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë është i kushtëzuar në çdo rast nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve ekzistues.

Ortaku, para se t'i transferojë në çdo formë kuotat e veta një ortaku ekzistues brenda shoqërisë apo një personi të tretë jashtë saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht të gjithë ortakët ekzistues nëse dëshirojnë të blejnë kuotat me të njëjtat kushte ekonomike si dhe në mënyrë përpjestimore sipas kuotave që zotërojnë në kapital të shoqërisë.

Në rast se të gjithë ortakët nuk përgjigjen me shkrim brenda 20 diteve nga njoftimi apo deklarojnë se nuk dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i lirë të transferojë kuotat e tij tërësisht apo pjesërisht në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë.

Në rast se një pjesë e ortakëve ekzistues përgjigjen me shkrim brenda 20 diteve dhe deklarojnë se dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i detyruar t'i transferojë kuotat e tij në drejtim të tyre në mënyrë të barabartë (dmth në rast se dy ortakë shprehin dëshirën për blerjen e kuotave, ato do t'i shiten të dy ortakëve në mënyrë të barabartë, pra 50% secilit).



Neni 8

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 8.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
- 8.3 Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKB.

Kreu IV

Asambleja e Përgjithshme

Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë, por pa u kufizuar, për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:
- a. përcaktimi i politikave tregtare;
 - b. ndryshime të Statutit;
 - c. emërimi dhe shkarkimi i administratorit/administratorëve;
 - d. emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e. miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c. dhe d.;
 - f. mbikqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga ana e administratorit/administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
 - g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
 - h. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
 - i. pjesëtimi i kuotave dhe anulimi i tyre;

- j. përfaqësimin e shoqërise në gjykime dhe ne procedime te tjera kundër administratorit/administratorëve të saj;
- l. riorganizimi dhe prishja e Shoqërise;
- m. miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- n. çeshtje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht."

- 9.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përmendura në pikat (g) dhe (h) më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.
- 9.3 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e minorancës sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi nëpërmjet një njoftimi me shkresë, me postë ose e-mail drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga të gjithë ortakët që zotërojnë 100% të kapitalit të shoqërisë.
- 9.4 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përmbajë në mënyrë të qartë datën, ditën, kohën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe do t'u dergohen të gjithë Ortakëve të Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes.
Në rast ndryshimi të rendit të ditës, do të ndiqet e njëjta procedure njoftimi që përshkruhet më sipër.

Neni 10


Kuorumi i nevojshëm

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo me pak se 31 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit të shoqërisë.

- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e Ortakëve vendos me 3/4 të ortakëve zotërues të kapitalit të shoqërisë me të drejtë vote, për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të zakonshme si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 11.4 Kryetari i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme do të jetë administratori i shoqërisë i cili do të drejtojë mbledhjen dhe asambleja e përgjithshme në çdo mbledhje të saj do të emerojë me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës edhe një person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.
- 11.5 Çdo vendim i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme do të regjistrohet në proces-verbal, i cili do të mbahet në përputhje me nenin 90 të ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.



Neni 12
Votat e Ortakëve

- 12.1 Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi.
- 12.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Kreu V
Administratori
Neni 13
Emërimi i Administratorit

13.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

13.2 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë **"AUTOMODIF GROUP ALBANIA" SH.P.K**

Z., Erdi Yuksel I biri i Seref, lindur më 18.06.1999 në Ayancik, Turqi dhe banuese në, Rr Bakalli, banesa 18, Yzberisht, njesia 14, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. U15542364, për një afat 5 vjeçar, nga momenti i regjistrimit të këtij fakti pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 14
Kompetencat e Administratorit

14.1 Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa më sipër dhe ligjit tregtar në fuqi.

14.2 Pa u kufizuar sa më sipër, në menyrë të veçantë, Administratori ka këto kompetenca:

- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë përsa i përket administrimit të zakonshëm;
- (ii) do të nënshkruajë çdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
- (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë më çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj,
- (iv) do të pergatisë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë çdo kontrate huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh apo borxh të mundshëm për Shoqërinë, hipotekë, peng apo çdo marrëveshje tjetër që krijon

apo mund të krijojë një barrë mbi pasuritë e Shoqërisë, marrëveshje garancie, kontratë për shitjen e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme të Shoqërisë. Të gjitha veprimet e parashikuara këtu (pika iv) do të jenë të vlefshme nëse janë të autorizuar shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë unanime;

- (v) do të urdhëroje dhe kryeje pagesa ne emer te Shoqerise – duke nenshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
- (vi) do te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
- (vii) do te pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme;
- (viii) do te krijojte nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (ix) do te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit nr. 9723, date 3 Maj 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (x) do t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;
- (xi) do te pergatise te gjitha planet per zhvillimin dhe operimin e Hidrocentraleve;
- (xii) do te marre ne pune, emeroje, shkarkoje te punesuar te Shoqerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesuar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktoje kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do te percaktoje shperblimin e tyre;
- (xii) te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.


Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa me sipër, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 15

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. ndodhet ose mund të ndodhet në kushtet e pa-aftesise fizike;
4. jep dorëheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine;



5. vdekjeje;
6. ndodhet ne situata apo rrethana te cilat e bejne te pamundur ushtrimin e detyrave te tij.

Neni 16

Kufizimet në Veprimet e Administratorit

- 16.1 Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqëritë tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqërie, në bazë të kuorumit të kërkuar, autorizo lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 16.2 Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Kreu VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 17

17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqëritë tregtare;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

- 17.2 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të

shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

- 17.3 Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKB, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKB-se.

Neni 18 Njoftimet

- 18.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 18.2 Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 19 Te Ndryshme

- 19.1 Çdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vlerën e saj.
- 19.2 Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nenligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohe pas kohe gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 19.3 Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 19.4 Në fund të çdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilet i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.
- 19.5 Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

NENI 20 Dispozita perfundimtare

- 20.1 Ky statut përben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet


dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar te percaktuar me siper.

20.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

Ky statut u redaktua ne **4 kopje origjinale të njëjta**, me permbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën Shqip dhe u nenshkrua nga palët pa asnjë rezerve.

ORTAKET THEMELUES

Orhan Yalçın



Erdi Yuksel

